

# Konventa Kombëtare për Integrimin European

## Newsletter

Janar - Prill 2021



Duke e kuptuar Integrimin në Bashkimin European jo thjesht si një axhendë institucionale, por si një projekt ambicioz zhvillimi i nxitur vazhdimisht nga e gjithë shoqëria; roli i shoqërisë civile dhe qytetarëve të angazhuar aktivisht është kyç për promovimin e vlerave europiane dhe rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik për ndikimin dhe përfitimet e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet legislative kanë lançuar “Konventën për Integrimin European” që prej vitit 2014. Konventa filloi në 2014 në një momentum me rëndësi për vendin tonë pasi sapo kishte marrë statusin kandidat. Gjatë implementimit të Konventës në 2014-2016 u organizuan 16 sesione të Grupeve të Punës dhe 2 sesione plenare fokusuar te integrimi european i vendit duke promovuar bashkëpunimin.

Duke qenë një model unik, i aplikuar fillimisht nga Slovak Foreign Policy Association dhe i zbatuar më pas në vende si Serbia, Mali i Zi, B&H, Maqedonia e Veriut, objektivi i konventës është institucionalizimi i debatit publik në çështje të lidhura me BE-në, mbështetur në bashkëpunimin mes qeverisë, shoqërisë civile dhe bizneseve. Nëpërmjet Konventës synohet rritja e pjesëmarrjes të të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare në formulimin e politikave kombëtare, forcimin e aftësive të ekspertëve në negociimin për integrimin european si dhe krijimi i një kanali të qëndrueshëm dhe interaktiv informimi për publikun e gjerë. Konventa u riaktivizua në 2019, duke ngritur katër Grupe Pune, ku secili përbëhet nga përfaqësues të strukturave qeveritare, si dhe ekspertë nga OJF-të, media, akademja dhe sektori privat. Grupet e Punës adresojnë kapitujt më sfidues për procesin e pranimit të Shqipërisë në BE: Grupi i Punës I: [Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore](#); Grupi i Punës II: [Drejtësia, Liria dhe Siguria](#); Grupi i punës III: [Bujqësia dhe Zhvillimi Rural](#); Grupi i Punës IV: [Fondet Strukturore](#); Grupi i Punës V: [Tregtia dhe Çështjet ekonomike](#)

---

GP I, Sesioni 2: Negociatat e Shqipërisë për anëtarësim në BE dhe përvoja rajonale – Kapitulli 23 në fokus	<a href="#">Faqe 2</a>
GP III, Sesioni 2: Standardet e marketingut dhe Prodhimi organik- përditësimi i legjislacionit europian	<a href="#">Faqe 3</a>
GP III, Sesioni 3: Politika e Përbashkët Bujqësore Europiane (CAP) – risitë dhe sfidat	<a href="#">Faqe 4</a>
GP IV, Sesioni 2: Organet e menaxhimit dhe zbatimit të programeve të financuara nga BE	<a href="#">Faqe 5</a>
	<a href="#">Faqe 6</a>

## Grupi i Punës I: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore

### Sesioni 2: “Negociatat e Shqipërisë për anëtarësim në BE dhe përvoja rajonale – Kapitulli 23 në fokus”

#### 5 shkurt 2021

Sesioni i dytë i Grupit I të Punës Kapitulli 23- “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” i cili u organizua në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, u hap nga një fjalim i *Adea Pirdeni* Zëvendës Ministre e Drejtësisë e cila u shpreh se në këto diskutime folësit do të ofrojnë ekspertizën rajonale, europiane dhe lokale në terma teknike për procesin e integritit me fokus kapitullin 23. *Etilda Gjonaj*, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, në fjalën e saj tha se qeveria shqiptare është fokusuar në ngritjen e një infrastrukture ligjore dhe institucionale të funksionimit të ligjit në Shqipëri. Reforma në drejtësi ka ridimensionuar tërësisht gjyqësorin shqiptar dhe ngritja e strukturave të specializuara kundër korrupsionit kanë kontribuar në luftën kundër mosndëshkimit. Më tej, *Gledis Gjipali*, drejtori ekzekutiv i EMA tha se kapitulli 23 është i një rëndësie të veçantë në procesin e integritit dhe suksesi që Konventa ka pasur në vendet e Ballkanit pritet edhe në Shqipëri. *Ján Figel*, ish-komisioner europian dhe ish-kryenegociator për Aderimin e Sllovakisë në Bashkimin Europian shpjegoi se si pjesë e unionit



vendet e Ballkanit Perëndimor kanë mundësi të përforcojnë vlerat bazë të përmendura edhe në Traktatin e Lisbonës si: dinjiteti njerëzor, liria, barazia dhe solidariteti. Ai shtoi se Shqipëria duhet të punojë më shumë dhe të krijojë marrëdhënie të mira me vendet fqinje si pjesë e përgatitjes për integrim. *Sofjan Jaupaj*, Shef i Kabinetit të Kryenegociatorit të Shqipërisë me BE paraqiti fjalën e Zef Mazi dhe dha më shumë detaje për rolin e kryenegociatorit në procesin e

integritit. *Tomas Strazay*, Drejtor i Qendrës Kërkimore të Shoqatës Sllovaqe për Politikën e Jashtme (SFPA) e vuri theksin te mundësia që jep konventa për shkëmbimin e eksperiencave sllovaqe dhe atyre europiane me vendin kandidat në kuadër të procesit të integritit në BE. *Fjoralba Caka*, ish-zëvendës ministre e Drejtësisë dhe njëkohësisht eksperte e së Drejtës Europiane foli për strukturat që duhen ngritur dhe nënvizoi zhvillimet e realizuara deri më tani nga Ministria e Drejtësisë në kuadër të procesit screening dhe Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian.

#### Rekomandimet (ekstrakt)

- Është i nevojshëm funksionimi i plotë i strukturave të sistemit gjyqësor dhe atyre speciale të ngritura kundër korrupsionit.
- Të vazhdojnë përpjekjet për rekrutimin e magistratëve të rinj të cilët duhet të përmbushin kriteret dhe standardet e transparencës, pavarësisë dhe përgjegjshmërisë, duke mos lënë mënjanë aftësitë profesionale të tyre.
- Lufta kundër korrupsionit duhet të vazhdojë ku në fokus duhet të jetë gjurmueshmëria dhe historiku i plotë.
- Të gjitha reformat që merren duhet të kenë parasysh përmbushjen e parimeve që janë themelore për BE.
- Qytetarët duhet të informohen dhe të përfshihen në procesin e Integritit Europian.
- Duhet marrë kohë dhe masa tranzitore për çështjet të cilat janë më të ndërlikuara dhe të ndjeshme.

## Grupi i Punës III: Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit

### Sesioni 2: “Standardet e marketingut dhe Prodhimi organik-përditësimi i legjislacionit europian”

21 prill 2021



Sesioni 2 i Grupit të Punës III Kapitulli 11 & 12 - Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit u organizua në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. *Gledis Gjipali* Drejtori Ekzekutiv i EMA në fjalimin e tij hapës foli për adaptimin e legjislacionit europian në vendin tonë. *Lauresha Grezda*, Drejtore pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural foli më specifikisht për kapitujt që Ministria e Bujqësisë koordinon dhe dy dokumenta që kanë të bëjnë me strategjitë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural,

Peshkimit dhe IPARD III. *Florian Xhafa*, u ndal në mënyrë të detajuar te legjislacioni për pjesën e prodhimit organik. *Viera Baričičová*, eksperte Sllovake mbi standardet e produkteve të freskëta realizoi një prezantim mbi standardet specifike të produkteve në BE, klasifikimin e tyre dhe së fundmi dha disa rekomandime për Shqipërinë.

#### *Rekomandimet (ekstrakt)*

- *Është i nevojshëm që sistemi i cilësisë në nivel kombëtar të përputhet dhe të jetë në linjë me standardet dhe kriteret e vendosura në nivel europian dhe ndërkombëtar.*
- *Në këtë mënyrë dhe vlerësimi i këtyre kriterëve është më i thjeshtë kur ato janë të unifikuara me standardet ndërkombëtare*
- *Duhet të ketë rritje të informimit dhe trajnimit të prodhuesve dhe ofruesve të produkteve bujqësore me fokus frutat dhe perimet e freskëta në lidhje me këto kriterë. Në radhë të parë të jenë të informuar për to e së dyti të bëhet e mundur rritja e kapaciteteve të tyre për ti arritur standardet*
- *Ngritje kapacitetesh kërkohet dhe për institucionet përgjegjëse shtetërore për vlerësimin e kriterëve dhe përcaktimin e tyre*

## Grupi i Punës III: Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit

### Sesioni 3: “Politika e Përbashkët Bujqësore Europiane (CAP) – risitë dhe sfidat “

28 prill 2021



Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural zhvilloi sesionin 3 të Grupit të Punës III. Pas fjalës përshëndetëse të drejtorit ekzekutiv të EMA, *Gledis Gjipali* fjalën e mori eksperti *Florian Xhafa* i cili u përqëndrua te te mbështetja për zhvillimin rural në Shqipëri dhe Programi IPARD, si një nga pikat e projektit IPA. Ai foli gjithashtu dhe për kushtet që duhet të plotësojnë

aplikuesit për të përfituar. Më tej, *Jan Barsvary*, eksperti sllovak mbi politikat bujqësore e filloi prezantimin e tij me dy shtyllat e strukturës CAP. Ai shpjegoi politikat kyçe dhe objektivat e ardhshme të CAP si dhe dha informacione shtesë për masat që BE mori gjatë periudhës së pandemisë. *Agim Rrapaj*, Kryetar i KASH foli për situatën aktuale të bujqësisë në Shqipëri. *Lauresha Grezda*, Drejtore pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural shpjegoi rëndësinë që ka lobimi i bërë nga përfaqësuesit e shtetit në zyrat e Brukselit dhe për grupin që pritet të dërgohet nga Shqipëria.

#### **Rekomandimet (ekstrakt)**

- Gjatë procesit të negociatave të vendit me BE është e një rëndësie të veçantë që të konsiderohen interesat kombëtare dhe të diskutohen prioritetet që lidhen me Kapitullin 11 dhe të tjerët (12, 28 dhe/ose 27).
- Qeveria duhet të financojë dhe ta mbështesë këtë sektor duke miratuar dhe zbatuar strategji dhe plane veprimi për bujqësinë.
- Financimi dhe mbështetja duhet të lidhen me modernizimin e industrisë së përpunimit të ushqimit.
- Është vënë në dukje një nevojë për të rritur kapacitetet në Ministrinë e Bujqësisë. Programet për rritjen e kapaciteteve duhet të miratohen dhe të zbatohen në mënyrë që stafi të trajnohet mbi praktikatat e BE-së dhe vendeve të tjera anëtare.
- Duhet inkurajuar procesi i regjistrimit dhe licensimit për bizneset dhe fermat duke ofruar ndihmë për ndjekjen e procedurave në mënyrë të rregullt për të mos pasur kosto shtesë.
- Nevojitet që ministria dhe institucionet përgjegjëse të organizojnë më shumë info-sesione dhe trajnime.



## Grupi i Punës IV – Fondet Strukturore

### Sesioni 2: “Organet e menaxhimit dhe zbatimit të programeve të financuara nga BE”

18 janar 2021



Sesioni II i Grupit të Punës IV me fokus Kapitullin 22 u fokusua te organet e menaxhimit dhe zbatimit të programeve të financuara nga BE. Pas fjalës hapëse të *Gledis Gjipalit*, drejtorit ekzekutiv të EMA i cili deklaroi se duke marrë parasysh pozicionin e Shqipërisë në

integrimin europian mundësitë që hapen me projektet e financuara nga BE-ja do vijnë duke u shtuar, fjalën e mori *Ermal Ilirjani*, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (ADF). Ai u shpjegoi rolin e autoritetit menaxhues të ADF në zbatimin e reformës së zhvillimit rajonal dhe kohezionit. *Florian Xhafa*, eksperti i brendshëm i Konventës prezantoi procesin e programimit të IPA III, risitë aktuale dhe bëri me dije se qeveria shqiptare ka filluar të përgatisë përgjigjet strategjike dhe aktualisht është në fazën e dërgimit të dokumenteve. *Vladimir Benč*, eksperti Sllovak në prezantimin e tij lidhur me temën mori si shembull përvojën e BE-së dhe Sllovakisë. Ai deklaroi se Komisioni Europian bën një analizë të detajuar të planit buxhetor të secilit shtet anëtar, sfidave makroekonomike dhe nevojave për reforma strukturore. Në varësi të përfundimeve qeverive u ofrohen rekomandime specifike për 12-18 muajt e ardhshëm. Benč vazhdoi duke bërë një raport të hollësishëm mbi objektivat e Sllovakisë për 2021-2027.

#### **Rekomandimet (ekstrakt)**

- *Institucionet shqiptare duhet të kenë një kornizë strategjike të përgatitur në kohë për të marrë pjesë në programin IPA III.*
- *Ndërhyrjet e propozuara duhet të justifikohen; si dhe duhet të përgatiten strategji të bazuara në prova dhe plane veprimi brenda kornizave fiskale.*
- *Nuk ekziston një nevojë e mëtejshme për të harmonizuar Acquis e BE-së me legjislacionin kombëtar për këtë sektor por vendi duhet të vazhdojë me ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të rëndësishme ndërkombëtare.*
- *Në dukje vihet një nevojë për trajnim të vazhdueshëm të stafit të fokusuar në kapitujt e IPA dhe Departamentet e hartimit të politikave në linjë me ministrinë për të rritur kapacitetet e tyre administrative për të menaxhuar e zbatuar projektet për IPA III.*
- *Përthithja e kapaciteteve vazhdon të përbëjë problem për institucionet shqiptare. Përmirësimi i tyre vjen duke analizuar problemet dhe duke hartuar strategji.*
- *Komuniteti i ekspertëve dhe shoqatat e shoqërisë civile duhet të përfshihen në planifikimin e fondeve të BE duke përdorur parimin e partneritetit mes aktorëve shtetërorë dhe strukturave jo-shtetërore.*

## Pritshmëritë e rezultateve të Grupeve të Punës:

- Rekomandime të politikave nga Sesionet e Grupeve të Punës;
- Hulumtime të përfundimeve nga GP (ekspertët e brendshëm të GP) ;
- Deklarata për shtyp dhe konferenca për shtyp
- Publikime të printuara (rekomandime: Seancat Plenaresë bashku me GP, hulumtimet e ekspertëve të brendshëm);
- Vendosja e bashkëpunimit të rrjetit think-tank lidhur me agjendën e Integritimit European me segmente të tjera të shoqërisëEU (qeveri, sipërmarrës, qeveritë vendore, etj...).

Informacione të mëtejshme lidhur me Konventën Kombëtare për Integrimin European mund t'i gjeni në faqen zyrtare të Konventës: [www.eurokoventa.al](http://www.eurokoventa.al)

